



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punëhojë/Prudato Received/Delivered	15.03.2023	viti god year	3
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtypja Printeg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	2722/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.267/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar, Arben Mehemi dhe Ardita Haxhnikaj Demianëtarë si dhe Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën A.nr.267/2023 të datës 30.01.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, përmes avokatit _____ me adresë banimi rruga "Sylejman Vokshi" 0-3 Hyrja Nr.5.Prishtinë, kundër organit të punësimit-Instituti i Kosovës për Administratë Publike në çështjen juridike "vërejte me shkrim" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.03.2023, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e bazuar ankesa A.nr.267/2023 e datës 30.01.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi vërejtja e datës 11.01.2023 me numër protokoll 002/2023 e shqiptuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ me datë 30.01.2023 me numër protokoll 1070/2023, për mes avokatit _____ ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Zëvendësuesi Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Kosovës për Administratë Publike me datë 11.01.2023 i ka shqiptuar vërejtje me shkrim në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi..

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil më datë 09.02.2023 me numër protokoll 1661/2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Instituti i Kosovës për Administratë

Publike, ndërsa me datë 23.02.2023 me numër protokoll 2012/2023, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 267/2023 e datës 30.01.2023, me numër protokoll 267/2023, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 16.01.2023; Vërejtje me numër protokoll 002, e datës 11.01.2023, i Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike; E- mail i datës 07.12.2022; Vendimi me numër protokoll 469 i datës 08.12.2020, i Drejtorit të Përgjithshme; e- maili i datës 13.12.2022 e- maili i datës 05.12.2022; e- maili i datës 18.12.2022; e- maili i datës 29.12.2022; Mendimi i datës 16.05.2016, i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Vërtetim i datës 01.02.2022, i lëshuar nga HANDIKOS; Raporti i Hyrje daljes për periudhën 01.01.2022, deri me datë 31.12.2022; e- maili i datës 13.10.2022; e- maili i datës 30.12.2022; e- maili i datës 24.12.2022; Dëshmi nga Kolegji AAB; e- maili i datës 07.12.2022; Raport i Angazhimit i një Ekspertit për Nevojat e IKAP; Raporti i Hyrje daljes për periudhën 01.01.2023, deri me datë 22.02.2023; ; e- maili i datës 04.01.2023; Detajet e pushimit vjetor të datës 22.02.2023; Vendimi i datës 18.12.2020 i Drejtorit të Përgjithshëm; ; Vendimi i datës 04.10.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm; Vendimi i datës 21.07.2017 i Drejtorit të Përgjithshëm; Vendimi i datës 27.08.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm; Akt emërimi i datës 18.11.2013; Përshkrimi i detyrave të Punës; Vërejte e datës 20.12.2021; Vendimi i An. 73/2022, i datës 28.03.2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 23.12.2022, i Komisionit Disiplinor; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 077 e datës 23.02.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është pa bazuar,*
SEPSE:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka trajtuar pretendimet e ankuesit të parashtruar përmes avokatit të tij, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit në vërejte me shkrim për ankuesin në pikën e parë ka shkruar se ankuesi me datë 30.12.2022 ka lëshuar vendin e punës gjegjësisht nuk ka qenë në vendin e tij të punës, ankuesi pretendon se kjo nuk qëndron dhe se dispozitat ligjore nuk parashohin që të përdoret sistemi elektronik për regjistrim të daljes nga vendi i punës. Kolegji duke trajtuar këtë pretendim të ankuesit ka konstatuar nga provat e lëndës se ankuesi me datë 30.12.2023 nuk e ka përdor regjistrimin elektronik të daljes nga puna, lidhur me këtë Kolegji ju ka referuar Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik respektivisht nenit 9 paragrafit 1, 2, 3 ku përcaktohet se " *Gjatë Orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë prezent në vendin e punës; Çdo Zyrtarë Publikë është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose regjistrimin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni; Mos regjistrimi në librat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mos prezencë në punë*". Prandaj Kolegji konstaton se mos regjistrimi i ankuesit në regjistrin elektronik kur ka dalur nga puna me datë 30.12.2023, është i konstatuar nga provat e lëndës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejt në këtë rast drejtë ka konstatuar gjendjen faktike dhe aspektet ligjore ndërlidhur me dispozitën e lartshënuar.

Kolegji duke ju referuar pretendimeve të ankuesit dhe Vërejtjes me shkrim të dhënë nga ana e mbikëqyrësit të tij, në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi me datë 7.12.2022 ka dërguar e-mail dhe ka njoftuar se për shkak të gjendjes shëndetësore nuk mund të delë në punë, por i njëjti nuk ka ofruar asnjë dëshmi mjekësore lidhur me gjendjen e tij, gjithashtu ankuesi me datë 5 dhe 6 janar 2023 ka njoftuar se do ti shfrytëzoj edhe dy ditë pushim vjetor që i takojnë pasi që ankuesi është person me aftësi të kufizuar sipas dokumentacionit mjekësor, por ankuesi sipas shkresave të lëndës nuk ka marr aprovim nga mbikëqyrësi lidhur me shfrytëzimin e pushimit vjetor, lidhur me këtë Kolegji ju referuar Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik respektivisht nenit 11 paragrafi 1, 2, 3, ku përcaktohet se "Për intervalin kohor të shfrytëzimit të pushimit vjetor, zyrtari publik duhet ta njoftojë mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor; Me rastin e lejimit të pushimit vjetor, zyrtarit publik i lëshohet vendim për orarin dhe kohëzgjatjen e pushimit vjetor më së paku pesë (5) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor; Kërkesa për pushim vjetor miratohet nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe njoftohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, miratimi apo refuzimi i pushimit vjetor, evidentohet në dosjen individuale të zyrtarit publik". Andaj ndërlidhur me këtë që u tha më lartë Kolegji konstaton se ankuesi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara sepse ka shkuar në pushim vjetor pa marrë aprovimin e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë.

Kolegji ka trajtuar edhe pretendimet e tjera të ankuesit, por të cilat nuk kanë ndikuar që vendim marrja të jetë ndryshe nga se është vendos në dispozitiv të këtij vendimi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se, mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit vërejtjen e ka shqiptuar në pajtim me nenin 47, paragrafi 1, si dhe nenin 48, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; **1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, si dhe nenin 8, paragrafi 1,2 Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se; 1. Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit. 2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuar në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit.**

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA A.nr. 267/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

Avokatit

Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike;

Udhëheqësit të Personelit të Institutit të Kosovës për Administratë Publike;

Arkivit të KPMSHCK-së,

